

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: L. H. nga fshati K. Komuna e P. dhe G.S. nga fshati P. e E. Komuna e P., për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1770-3/2008 dt.02.02.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 14.04.2016, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Gjejrone Alaj, të dëmtuarit B. I., të akuzuarve, me datë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin me datë 15.04.2016, ndërsa me datë 29.04.2016 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L. H., i biri i R. dhe S. e gjinisë M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin K. Komuna e P., ku edhe jeton, me nr. Personal: *numër personal...*, i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, me profesion shofer, i gjendjes së mesme ekonomike, kundër tij nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, ka qenë i gjykuar, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë.

I akuzuari G. S., i biri i H. dhe F. e gjinisë G., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin P. e E. Komuna e P., me nr. personal: *numër personal...*, i martuar, babai i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-rast social, kundër tij nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, nuk ka të dhëna se më par ka qenë i gjykuar, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Më dt.23.03.2008, në intervalin kohor rreth orës 21:30 e deri më më 22:00, në Oborrin e shtëpis e tani të dëmtuarit B. I., që gjendet në fshatin K. KK.P., të pandehurit në bazë të marrëveshjes paraprake e me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme në mënyrë të kundërligjshme, kanë depërtuar në oborrin e shtëpis së tani të dëmtuarit B. I. dhe në momentin kurr rryma ka qeën e ndalur, dhe me sopat kane këputur telin e rrymës, 5x8 m, i cili ka qenë i vendosur në shtyll në lartësi prej 50 cm dhe me shpejtësi janë larguar nga vendi i ngjarjes me ç`rast të dëmtuarit i kanë shkatuar dëmë material, ndërsa të njëjtën sasi të kabllës G. S. e ka dërguar dhe shitur në deponin e hekurishtave, djalit të pronarit, H. B., Sh. i moshes 14 vjeqar.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,6,11,15,23,34,41,42,43,44,64, dhe 253 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463, të KPPPK-së, e

G J Y K O N

I.Të akuzuarin **L. (R.) H.**, me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale.

II.Të akuzuarin **G. (H.) S.**, me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

III. Detyrohet i akuzuari L. H., që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-paushalle të paguajë shumën prej **50€** (pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa i akuzuari G. S. lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale-paushalle, pasi që i njëjti është përfitues i ndihmës sociale.

IV.I dëmtuari B. (Rr.) I., nga fshati K., KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

PPK-në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.1770-3/2012 dt.02.02.2011, kundër të akuzuarve: F. H., L. H. dhe G. S., bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestarë të datës 04.02.2016 me pëlqimin e palëve ka marrë aktvendim të veçantë për veçimin e procedurës penale kundër të pandehurit F.(R.)H., pasi që Stacioni Policorë në Podujevë me informatën e datës 29.01.2016 e ka njoftuar gjykatën se i njëjti gjendet në Gjermani, dhe procedura ka vazhduar kundër të akuzuarve tjerë.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit, dhe të akuzuarve.

Të akuzuarit në të gjitha shqyrtimit gjyqësore u deklaruan të pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohen.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi, mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve: L. H. dhe G. S., nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se të

akuzuarit kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe i propozoi gjykatës që t'i shpallë fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaroi se ja lë gjykatës të vendos, ndërsa parashtroi kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari L. H. në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i cili nuk e ka pranuar fajësinë për veç tjerash deklaroi: Nuk i kujtohet ditën kritike ku ka qenë, por ka qenë në oborrin e B. I. për të punuar një ditë dhe ju ka paguar dhe nuk i kujtohet deklarata e dhënë në polici, si dhe kërkoi nga gjykata që ta shpall të pa fajshëm.

I akuzuari G. S. në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i cili nuk e ka pranuar fajësinë për veç tjerash deklaroi: Se shkon nga një herë në fshatin Kërpimëhë, por ditën kritike nuk i kujtohet se ka parë F. dhe L., po ka shtuar se zakonisht edhe këta mbledhin potkoj dhe i ka takuar nga njëherë dhe nuk i kujtohet deklarata e dhënë në polici dhe kërkoi nga gjykata që ta shpall të pa fajshëm.

Gjykata ka administrua provat e propozuara dhe atë: ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin B. I., dëshmitarin H. B. dhe sh. B. dhe është shiqur fotodokumentacioni të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari-dëshmitari B.I. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Se ditën kritike kur është ndal rryma në fshat e kam parë te dyert e mia L. H. me një bateri në dorë dhe i thash se çfarë po kërkon këtu, më tha se asgjë veç po sillem, kamë shkuar në Podujevë dhe kur jam kthyer kamë parë se nuk ka rrymë dhe nuk e kamë gjetur kabllon.

Dëshmitari H. B. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Se në vitin 2008 kam punuar në hekurishte me ndërrime dhe kur kam munguar më ka zëvendësuar djali sh. i cili më ka informuar për çdo gjë që ka ndodhur, i cili e ka pranuar se ka dhënë deklaratë në polici me datë 08.04.2008 dhe e ka nënshkruar, por nuk i kujtohet se çka ka deklaruar. Në deklaratën e dhënë në polici me datë 08.04.2008, djali im Sh. më ka informuar se me datë 23.03.2008 te deponia G. S. e kishte qar një paketë me kabull të pa djegur dhe ata kabull të njëjtën ditë së bashku me djalin tim e kishin djegur afër ndërtesës të ish kooperativës bujqësore, pastaj djali im ja kishte blerë kabllon e djegur, gjithashtu G. S. nga fshati P. me datë 24.03.2008 pasdite e kishte sjellë një paketë tjetër me kabull të pa djegur dhe lokacionin e njëjtë e kishte djegur dhe shitur prapë djalit tim Sh..

Dëshmitari Sh. B. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar: Se gjatë vitit 2008 kam punuar në deponin e hekurishte duke zëvendësuar prindin, dhe ka shtuar se të akuzuarit nuk kanë prurë sende me vlerë në hekurishte, ndërsa vendi ku është djegur kabloja është afër deponisë së hekurishte.

Nga fotodokumentacioni shihet vendi ku është djegur kabloja me qëllim për shitje.

Gjykata vërtetoi gjendjen faktike nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit B. I. deklarata e dëshmitarit H. B. dhënë në polici dhe fotodokumentacionit dhe pjesërisht nga deklarata e të akuzuarit G. S., dhe ju fali besimin nga se ndërliiden me njëra tjetrën e nga të cilat u vërtetua se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarve, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprat penale me dashje.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarve, kështu që gjykata gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarve duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti se L. H. kishte sjellja të mira gjatë gjykimit, në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, ndërsa rrethanë rënduese gjeti se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë, kurse si rrethana lehtësuese për të akuzuarin G. S., ka gjetur se kishte sjellja të mira gjatë gjykimit, i gjendjes së varfër ekonomike rast-social, për të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, ndaj tyre nuk zhvillohet procedurë tjetër penale duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është prona private, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandalojë nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për lirim nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale për të akuzuarin G. S. është marr duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPPRK-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe familjes së tij, pasi që i akuzuari është përfitues i ndihmës sociale bazuar në Kartelën e Ndhmës Sociale me nr..... të datës 06.08.2015.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që nuk ka pasur prova të sakta mbi dëmin e shkaktuar.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
Pka.nr.25/11, dt.29.04.2015

Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.